



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës 26.09.2008 , Kryetari i Komunës propozon Kuvendit të Komunës që :

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, dhe 17 pika r) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , dhe neneve 9 pika r) , 20 par 20.1, dhe 51 pika b) dhe pika dh) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2023 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR PËRCAKTIMIN E FESTIVALIT “**RINIA FEST - LIPJAN**” SI FESTIVAL TRADICIONAL I KOMUNËS SË LIPJANIT

I.Me këtë Vendim përcaktohet që festivali “**Rinia Fest - Lipjan** ”, të jetë festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

II. Festivali tradicional “**Rinia Fest - Lipjan** ”do të mbahet çdo vit me datën 12 gusht , për nder të Ditës ndërkombëtare të rinisë 12 gushtit dhe mund të zgjasë edhe më shumë se një (1) ditë varësisht nga agjenda e planifikuar për secilin vit përkatës.

III. Për organizimin dhe mbajtjen e këtij Festivali do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Lipjanit.

IV.Mjetet financiare për organizimin dhe mbajtjen e këtij Festivali do të sigurohen nga buxheti i Komunës.

V. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës.

Qëllimi i miratimit të këtij Propozim-Vendimi është që festivali **“Rinia Fest - Lipjan”** të jetë festival tradicional i Komunës së Lipjanit, i cili planifikohet të mbahet për nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, 12 gushtit, në secilin vit përkatës.

Dita Ndërkombëtare e Rinisë (International Youth Day - IYD) është një ditë ndërkombëtare e ndërgjegjësimit e përcaktuar nga Kombet e Bashkuara. Qëllimi i kësaj dite është të tërheq vëmendjen për një grup të caktuar çështjesh kulturore dhe ligjore që preokupojnë rininë. Dita Ndërkombëtare e Rinisë për herë të parë u shënuar më 12 gusht të vitit 2000.

Dita Ndërkombëtare e Rinisë meriton të festohet në komunën tonë, pasi vlersojmë që e kemi një resurs të pazëvendësueshëm të vendit, rininë tonë.

Festivali **“Rinia Fest – Lipjan”** do të ketë datë të caktuar të mbajtjes.

Festivali do të organizohet enkas për të rinjtë e vendit tonë.

Me këtë Propozim-Vendim është menduar që edhe Komuna e jonë të ketë një Festival tradicional që realizohet për të rinjtë e Komunës së Lipjanit me titull **“Rinia Fest - Lipjan”**.

Nga të cekurat më lartë, i propozojmë Kuvendit të Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 644/01-46717
Lipjan, më 29.08.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

